



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 6364/Prot.

Tiranë, më 30.11.2022

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 135, datë 30.11.2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a/b të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP") në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Përparim Agimi" p.f., me NUIS M12506803T, nga e drejta për të fituar kontrata publike për:

- Keqinformim për qëllime kualifikimi në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje moket për ambientet e MFE-së", me Nr. REF-36087-07-12-2022, të zhvilluar në datën 13.07.2022, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (në vijim "MFE"), në përfundim të së cilës është shpallur fitues operatorit ekonomik "Përparim Agimi" p.f., me NIPT M12506803T, me ofertë ekonomike 960.000 lekë (pa TVSH);
- Mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në realizimin e kontratës Nr. 6498/2 Prot., datë 15.08.2022, me objekt: "Shpenzime për blerje kripe", me vlerë 2.880.000 lekë (me TVSH), të procedurës së prokurimit me Nr. REF-35233-07-04-2022, të nënshkruar me Bashkinë Korçë.

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23 të LPP.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Përparim Agimi" p.f., me NUIS M12506803T, me adresë: Rruga "Plepa - Golem", Z. Kadastrale Nr. 2291, Kryemëdhenj, Kavajë.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") është vënë në lëvizje nga kërkesa e MFE, e cila me shkresën Nr. 13098/2 Prot, datë 25.08.2022, ka kërkuar përjashtimin e operatorit ekonomik "Përparim Agimi" p.f. nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim për qëllime kualifikimi, si edhe nga kërkesa e Bashkisë Korçë, e cila me shkresën Nr. 7759 Prot., datë 13.09.2022, ka kërkuar përjashtimin e subjektit në fjalë nga e drejta për të fituar kontrata publike, për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e nenit 78/1/a/b të LPP, në të cilin përcaktohet se: "1. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për:

- a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi;
- b) mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik".

III. Masat:

Me Vendimin Nr. ¹³⁵ datë 30. 11. 2022, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Përparim Agimi" p.f., me NUIS M12506803T, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për 8 (tetë) muaj hyrja në fuqi e këtij vendimi.